



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KAVAJË
KRYETARI**

Nr. 1329 prot.

Kavajë, më 31.03 2023

Lënda: Kërkesë për mendim mbi rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar .

Drejtuar: Ministrise së Turizmit dhe Mjedisit

Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, 1001 Tiranë, Shqipëri

Për dijeni : Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

"Muhamet Gjollësja" 57, Tiranë, Shqipëri

Mbështetur në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", e ndryshuar,

Bashkia Kavajë me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 08 datë 23/03/2022 dhe vendim të Këshillit Bashkiak Nr.45 datë 14/06/2021 ka ndermarrë nismën për "Rishikimin Pjesor të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar".

Pas konsultimeve me qytetarë të Bashkisë Kavajë, investitorë me potencial të vegjël dhe të mëdhenj në fushën e turizmit, industrisë apo ndërtimit të cilët kanë ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e zonës u hartua draft dokumenti i rishikimit pjesor të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Kavajë.

Ky draft dokument u konsultua hap pas hapi ne rruge elektronike zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Theksojmë se ndryshimet konsistojnë vetëm në treguesit zhvillimor ne zonat urbane dhe ndryshimit të kufijve të njësive strukturore pa cenuar tokat bujqësore dhe mjedisin bazuar ne raportin e ekspertit mjedisor bashkelidhur kësaj shkrese.

Kërkojme nga ana juaj mendimin nëse jemi apo jo në kushtet që duhet ti nënshtrohemi Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Bashkëlidhur gjenden :

- Draft dokumenti I rishikimit pjesor të planit të përgjithshëm vendor , në CD
- Raporti i ekspertit mjedisor

Duke ju falenderuar për mirkuptimin !

Punoi : S.VELIU 
Kontrolloi : H.ZOLLOTA 
Miratoi : D.QATO

**KRYETARI I BASHKISË
REDJAN KRALI**

**NË MUNGESË DHE ME ÛRDHËR
ZV.KRYETARI
GUXIM KOLA**

